

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVACCJW
Më
Dana 14 - 02 - 20 18

P.nr.981/16

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, e përbërë nga gjyqtari i vetëm gjykues, Hysnije Gashi, me procesmbajtësen Ibadete Haliti, në lëndën penale kundër të pandehurit, [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], Komuna [REDAKTUAR], i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1723-2/15 të dt.10.10.2016, për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK-se, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokuroria Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1723-2/15 të dt.10.10.2016 për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt.18.11.2016 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1723-2/15 të dt.10.10.2016 dhe kjo gjykatë jep këtë:

U R D H Ë R N D Ë S H K I M O R

I pandehuri, [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], Komuna [REDAKTUAR], i lindur më dt. [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ema [REDAKTUAR] e vajzeris [REDAKTUAR], i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetas e Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

Sepse me dt. 02.06.2015, rreth ores 23:40, në Shtime, në rrugën e transitit, duke drejtuar automjetin e tij të markës "VW Golf", me targa të regjistrimit [REDAKTUAR], prej drejtimit të fshatit Davidovc në drejtim të Shtimes, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 126/1 të LSKRR- se, nga pakujdesia, duke mos e mbajtur distancën e sigurisë me pjesën e përparme të godet në pjesën e pasme të automjetit të markës "VW Polo", me targa

te regjistrimit [REDACTED], te cilen e drejtonte [REDACTED] nga [REDACTED], me te cilin rasdt pos demeve materjale, lendime te lehta trupore peson [REDACTED]

Me të cilën kreu veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 te KPK-se

Gjykata në bazë të nenit 4,41,46, dhe 73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së

G J Y K O N

Denim me gjobë në lartësi prej 200 € (dy qindë euro) të cilin denim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 dite, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

Në rast se denimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe forma tjera sipas nenit 39 të KPK-së ,do të shëndrrohet në denim me burg, ashtu që për çdo 20 Euro do të i llogaritet me 1(një) ditë burg.

Gjykata te dëmtuarën, [REDACTED] për realizimin e kërkesës pasurore juridike në bazë të nenit 459 par. 1 të KPPK-së e udhëzon në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve te procedures penale te paguaj Shumen prej 55 euro, dhe te paushallit gjyqesor 20 euro, në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.1723-2/15 të dt.10.10.2016 , ka akuzuar të pandehurin [REDACTED], për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 te KPK-se, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës, si konstatimi i ekspertit mjeko- ligjor i dt. 26.02.2016, mendimi i ekspertit te komunikacionit i dt. 17.10.2015, deklarata e te pandehurit e dt. 02.06.2015, deklarata e te dëmtuarës e dt. 02.06.2015, dhe provat e tjera vërtetojnë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpall fajtor dhe i shqipton dënimin sipas ligjit.

Gjykata te dëmtuarën [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore juridike në bazë të nenit 459 par. 1 të KPPK-së e udhëzon në kontest civil.


I pandehuri është obliguar që të paguaj shpenzimet procedurale dhe paushallin gjyqësor komforë nenit 450 par 2.6 të KPPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr. 981/16 dt. 18.11.2016.

**Praktikante
Ibadete Haliti**

**Gjyqtarja
Hysnije Gashi**



UDHËZIM JURIDI

Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet kundërshtim,
në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit
të njëjtës gjykatë.